

FOL

**Udhëzues
për sinjalizimin
në sektorin
privat**





**Udhëzues
për sinjalizimin
në sektorin
privat**

Titulli: Udhëzuesi për sinjalizimin në sektorin privat

Publikuar nga Lëvizja FOL

Web: www.levizjafol.org

Address: Andrea Gropa, No.35
10000 Prishtinë, Kosovë

Të drejtat e autorit @ 2020. Lëvizja FOL. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij Udhëzuesi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes së të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë elektronike, mekanike, fotokopjuese, incizuese apo tjetër, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga ana e botuesit.



Norwegian Embassy



Publikimi i këtij Doracaku është mundësuar nga 'Programi i shoqërisë civile për Shqipërinë dhe Kosovën', financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në partneritet me Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (PA). Përbajtja dhe rekomandimet e paraqitura nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtar të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).

08

- Qëllimi i udhërrëfyesit
- Interesi publik
- Interesi privat
- Integriteti

09

- Pse të sinjalizojë
- Sektori privat
- Kush është sinjalizuesi
- Personi i lidhur me sinjalizuesin

10

- Çka është sinjalizimi
- Shkeljet që sinjalzohen
- Sinjalizimi në vendin e punës

11

- Zyrtari përgjegjës
- Paraqitja e rastit
- A duhet të paraqiten provat

12

- Afatet procedurale
- Shqyrtimi i rastit
- Palët në procedurë
- Përfundimi i hetimit

13

- Krijimi i procedurave të brendshme
- Sinjalizimi jashtë vendit të punës
- Organet rregullatore

14

- Sinjalizimi publik
- Mbrojtja nga veprimet e dëmshme
- Mbrojtja gjyqësore

15

- Vendimet e gjykatës
- Dënimet për kundërvajtje

16

- Veprimet për zbatim të Ligjit
- Raportimi vjetor për rastet e sinjalizimit

17

- Rekomandimet

19

- Shtojca A

25

- Shtojca B

I. HYRJJE

Sektori privat është pjesë integrale e sektorit ekonomik kombëtar. Roli i tij është thelbësor, për shkak se kontribuon në të ardhurat kombëtare nga taksat dhe siguron qarkullimin efikas të shërbimeve dhe kapitalit. Ky sektor është në pronësi dhe i menaxhuar nga individë dhe organizata që kanë për qëllim të gjenerojnë fitim. Sektori privat është ofruesi kryesor i mallrave dhe shërbimeve për komunitetin. Prandaj, siguria dhe cilësia e këtyre mallrave dhe shërbimeve janë jetike për qytetarët.

Por, në kuadër të këtij sektori, mund të ndodhin veprime apo praktika të cilat paraqesin kërcenim apo cenim të interesit të përgjithshëm. Të punësuarit në kuadër sektorit privat apo personat tjerë të cilët kanë kontakte pune me këtë sektor, shpesh janë të parët që dinë për veprimet që dëmtojnë interesin publik. Por, për arsye të ndryshme, ata në të shumtën e rasteve qëndrojnë të heshtur apo indiferentë ndaj këtyre veprimeve. Sepse, konsiderohet se procedurat e raportimit nuk janë efikase apo se sinjalizimi mund t'u sjellë probleme në vendin e punës në një formë apo tjetër. Por, sinjalizimet e shkeljeve në sektorin privat mund të luajë rol thelbësor në mbrojtjen e shëndetit të njerëzve, sigurisë së produkteve ushqimore, apo përmirësimin e cilësisë së shërbimeve. Prandaj, është shumë e rëndësishme që këto veprime të sinjalizohen dhe të mos mbeten të heshtura.

Fusha e sinjalizimit dhe mbrojtja e sinjalizuesve është një fushë e re dhe sui generis. Ligji i ri për mbrojtjen e sinjalizuesve ka për qëllim krijimin e procedurave të qarta ligjore, shpjegimin se si bëhet raportimi i këtyre shkeljeve dhe garantimin e mbrojtjen e sinjalizuesve. Ligji ka fushëveprim në sektorin publik dhe privat, sepse veprimtaritë e këtyre sektorëve janë të ndërlidhura. Praktikata tregojnë se në shume raste një veprim apo shkelje bëhet përmes bashkëpunimit mes organizatave (personave) nga sektori publik dhe privat. Ligji i ri për Mbrojtjen e Sinjalizuesve ka për qëllim promovimin e sinjalizimit, duke siguruar mbrojtjen efikase të sinjalizuesve. Ligji nuk ndërhyt në fushëveprimin e ligjeve tjera, por zbatimin e tij është i ndërlidhur edhe me zbatimin e legjislativitetit penal; të punës; kundër korrupsionit dhe krimin ekonomik; kodit të etikës, planit të integritetit etj.

Por, zbatimin e tij për zbatimin efikas i Ligjit, kërkon angazhimin e institucioneve publike, sektorit privat, të punësuarave, shoqërisë civile dhe mediave. Avokimi i shoqërisë civile është thelbësor, sepse rrit llogaridhënien, inkurajon sundimin e ligjit dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. Një prej sfidave më të mëdha në rrugëtimin e zbatimit të ligjit, konsiderohet sektori privat. Për këtë arsye edhe dispozitat ligjore për këtë sektor kanë hyrë në fuqi një vit më vonë se sa për sektorin publik.

Lëvizja FOL në vazhdimësi është e angazhuar për përmirësimin e kornizës ligjore dhe ambientit për mbrojtjen e sinjalizuesve. Udhëzuesi për sinjalizimin në sektorin privat, është pjesë e pakos së aktiviteteve në kuadër të projektit "Sinjalizues, ligji ju mbron". Udhërrëfytyesi synon të përdoret si një mjet reference për të punësuarit në sektorin privat, lidhur me procedurat e sinjalizimit. Në shtojcën A është bashkëngjitur një Model Rregullorë e cila mund të shërbejë si udhëzues për hartimin e akteve të brendshme të sektorit privat për zbatimin e ligjit. Ndërkaq në shtojcën B është Analiza e gjendjes aktuale në lidhje me zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve në sektorin privat.

Qëllimi i udhërrëfyesit

Udhërrëfyesi përmban udhëzime të përgjithshme të cilat lehtësojnë kuptimin dhe përmbajtjen e Ligjit Nr. 065/L-085 Mbrojtjen e Sinjalizueseve, lidhur me sinjalizimin në sektorin privat.¹ Ky udhërrëfyesi është modeluar për t'ju ardhur në ndihmë të gjithë të punësuarave në sektorin privat, të cilët mund të sinjalizojnë veprimet apo praktikatat e dyshimta në vendin e tyre të punës. Udhërrëfyesi përmban pika konkrete të referencës se si duhet të veprojnë në rast se të punësuarit vendosin të sinjalizojnë dhe si t'i realizojnë të drejtat e tyre si sinjalizues.

Interesi publik

Sinjalizimi bëhet vetëm për interes publik dhe jo për interes personal apo privat. Motivët që ndikojnë për të sinjalizuar janë të ndryshme, por ligji vendos prezumimin e interesit publik për sinjalizim. Përbërësit kryesorë të interesit publik janë: të drejtat themelore; siguria njerëzore, shëndeti dhe mirëqenia sociale, zhvillimi ekonomik dhe trashëgimia kulturore. Interesi publik është interesi ynë i përbashkët.

Interesi privat

A mund të sinjalizohet për një interes apo pakënaqësi personale? Jo. Ligji përcakton se sinjalizimi mund të bëhet vetëm për të mbrojtur interesin publik. Për realizimin e interesave apo drejtave personale, individët ndjekin procedurat administrative brenda dhe jashtë institucionit apo procedurat gjyqësore.

Integriteti

Integriteti mes tjerash përfshin: respektimin e standardeve të etikës; mbizotërimin e interesit publik; raportimin e praktikave apo veprimeve të cilat shpien në keqpërdorime; promovimin e të drejtave të njeriut, duke shmangur ngacmimin dhe diskriminim; promovimin dhe rekrutimin transparent dhe në bazë të rezultateve (performancës).

¹ Ligji Nr. 065/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 22/18 dhjetor 2018, Prishtinë. Ndërsa dispozitat që i referohen sektorit privat fillojnë të zbatohen një (1) vit pas hyrjes së tij në fuqi. Ligji reflekton dhe integron parimet dhe standardet evropiane të parapara me Rekomandimin e Këshillit të Evropës (2014)/7 dhe Direktivën e Parlamentit dhe Këshillit Evropian për Mbrojtjen e Sinjalizuesve.

Pse të sinjalizoj?

Sinjalizimi në sektorin privat është një nga mënyrat më efektive për të zbuluar shkeljet e ndryshme. Ky sektor është furnizuesi kryesor me mallra dhe shërbime dhe sinjalizimi mund të shpëtojë jetë njerëzish, shuma të mëdha fondesh, sigurinë e ambientit, pengimin e korrupsionit, keqpërdorimin e parasë publike përmes prokurimit publik apo shkelje tjera të cilat e dëmtojnë interesin publik.

Sektori privat

Ky sektor përbehet nga të gjitha subjektet juridike (etnitet ligjor) jashtë sektorit publik. Sipas legjislacionit, ky sektor përfshin (i) shoqëritë tregtare; (2) organizatat joqeveritare dhe (iii) çdo organizatë tjetër të themeluar në bazë të ligjit. Shoqëritë tregtare janë: bizneset individuale, ortakëritë e përgjithshme, ortakëritë e kufizuara, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare.² Organizata joqeveritare janë personat juridik të cilët mund të organizohen në tri forma, si në vijim: shoqatë, fondacion dhe institut.³ Ndërsa, kategoria e tretë përfshinë personat juridik të cilët kanë fushëveprim specifik dhe rregullohen me ligje të veçanta si: Partitë politike, Komunitetet fetare; Sindikatat; Kryqi i Kuq i Kosovës, etj.

Kush është sinjalizues?

Sinjalizues mund të jetë çdo i punësuar në sektorin privat, i cili në kontekstin e punës së tij, sinjalizon. Sipas Ligjit, kategori të personave të cilët kanë të drejtë të sinjalizojnë janë:

- të punësuarit dhe ish-të punësuarit, pavarësisht nga kohëzgjatja, pagesa dhe natyra e punës;
- bashkëpunëtorët e jashtëm apo të rastit;
- kandidatët për punësim; vullnetarë; personat në praktikë profesionale apo trajnim;
- kontraktorët apo nënkontraktorët e shërbimeve.

Personi i lidhur me sinjalizuesin

Personi i lidhur me sinjalizuesin është ai personi i cili ndihmon sinjalizuesin ose mund të ofrojë prova të lidhura me sinjalizimin, apo çdo person tjetër që mund të dëmtohet për shkak të çfarëdo lidhjeje me sinjalizuesin. Ky person ka të gjitha të drejtat dhe mbrojtjen ligjore, sikur edhe sinjalizuesi.

² Ligji nr. 06/L -016 për Shoqëritë Tregtare, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/nr. 9/24 maj 2018, Prishtinë, Neni 5. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16426>.

³ Ligji nr. 06/L- 043 për Lirinë e Asocimit në Organizata Joqeveritare, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/nr.11/24 prill. 2019, Neni 19, Prishtinë, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=19055>.

Çka është sinjalizimi?

Sinjalizimi është raportimi apo shpalosja e informacionit në lidhje me shkeljet e ndryshme në dëm të interesit publik që mund të ndodhin në sektorin privat. Përmes sinjalizimit bëhet zbulimi i informacionit mbi aktivitetet e paligjshme, mashtruese ose të rrezikshme që kryhen brenda institucionit. Ligji përcakton tri lloje të sinjalizimit: sinjalizimi i brendshëm: sinjalizimi i jashtëm dhe sinjalizimi publik.

Shkeljet që sinjalizohen

Përmes sinjalizimit, i punësuari i sektorit privat raporton apo shpalosë informacione për cilat beson se janë në interes të publikut dhe kanë tendencë të tregojnë se një ose më shumë nga çështjet vijuese po ndodhin tani, kanë ndodhur në të kaluarën ose ka të ngjarë të ndodhin në të ardhmen:⁴

- një vepër penale;
- shkelje e një detyrimi ligjor;
- keqadministrimi i drejtësisë;
- shkatërrimi i ambientit;
- rrezikimi i shëndetit apo sigurisë së individit;
- një mbulim të qëllimshëm të informacionit që synon të tregojë ndonjë shkeljet e më sipërme;
- veprimet diskriminuese dhe shtypëse;
- mbrojtja e konsumatorit dhe konkurrencës.

Sinjalizimi në vendin e punës

Sinjalizimi i brendshëm bëhet në kuadër të ndërmarrjes apo biznesit ku punon sinjalizuesi. Ky raportim konsiderohet si mënyra më e mirë për të marrë informacione relevante të cilat mund të kontribuojnë në zgjidhjen e hershme dhe efektive të rrezikut dhe kërcënimit ndaj interesit publik. Parimisht duhet të provohet të përdoret sinjalizimi i brendshëm.

⁴ Ligji Nr. 065/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, Neni 5.

Zyrtari përgjegjës

Çdo subjekt privat i cili ka pesëdhjetë (50) e më shumë të punësuar ka obligim ligjor të caktoj zyrtarin përgjegjës për shqyrtimin e rasteve të sinjalizimit. Te ky zyrtar bëhet paraqitja e rasteve të sinjalizimit brenda subjektit privat. Zyrtari vepron në bazë të parimit të ndershmërisë, konfidencialitetit, dhe duke shmangur konfliktin e interesit. Në rast se numri i të punësuarave është më i vogël se pesëdhjetë (50), sinjalizimi i brendshëm bëhet drejtpërdrejtë tek drejtuesi i institucionit (drejtori apo menaxheri kryesor). Por, të punësuarit mund të bëjnë sinjalizim të drejtpërdrejtë edhe në rastet tjera: (i) kur zyrtari përgjegjës është i përfshirë në rastin e dyshuar; (ii) kur ka dyshim të arsyeshëm se zyrtari është i papërshtatshëm për të paraqitur rastin; (iv) kur ka dyshim të arsyeshëm se procedurat e brendshme nuk janë efektive.

Paraqitja e rastit

Sinjalizimi mund të bëhet me shkrim, me postë, telefon, e-mail, dhe gojarisht. Nëse sinjalizoni një rast, zyrtari përgjegjës pranon informacion duke krijuar një regjistër i cili përmban të dhënat kryesore për sinjalizuesin dhe datën e pranimit. Në fakt, ky regjistër është libri (blloku) në të cilin regjistrohen rastet me radhë të cilat sinjalizohen në kuadër të biznesit privat. Sinjalizuesit në momentin e parashtrimit të rastit i jepet dëshmi për informacionin e paraqitur dhe lista me emrat e dokumenteve të cilat janë paraqitura lidhur me rastin.

A duhet të paraqiten provat?

injalizimi kryhet kur kemi “besim të arsyeshëm” për vepra apo praktika të dyshimta jo në “dyshimin e bazuar mirë”. Pra, sinjalizuesi në momentin e sinjalizimit beson me vetëdije se ekziston kërcënimi apo cenimi i interesit publik. Sinjalizuesi nuk është i detyruar ta provojë mirëbesimin dhe vërtetësinë e informacionit të sinjalizuar, dhe nuk ka detyrim të mbledhë apo sigurojë prova.

Afatet procedurale

Kur një rast sinjalizohet, ai duhet të trajtohet sa më shpejt që është e mundur. Pas raportimit, brenda afatit 15 ditor, zyrtari përgjegjës (punëdhënësi) e njofton sinjalizuesin për statusin e sinjalizimit. Pra, gjatë këtij afati, informacioni filtrohet dhe varësisht nga përmbajtja e tij do të vlerësohet nëse do të vijohet tutje me hetimin administrativ të rastit. Afati për shqyrtimin e rastit të sinjalizimit është 45 ditë dhe në rast të rrethanave specifike përjashtimisht mund të zgjasë edhe 45 ditë tjera, duke mbyllur ciklin kohor prej 90 ditësh, nga dita e regjistrimit të rastit.

Shqyrtimi i rastit

Gjatë hetimit administrativ bëhet vlerësimi i fakteve dhe rrethanave relevante për trajtimin e rastit. Nëse është e nevojshme, zyrtari përgjegjës, mund të kërkojë informacione shtesë nga personat relevant, të urdhëroj inspektime dhe të konsultohet me ekspert përkatës. Këto veprime ndihmojnë zyrtarin përgjegjës ta zbatojë një hetim të plotë, të përshtatshëm dhe të saktë për të zbardhur (sqaruar) të vërtetën objektive. Gjatë hetimit administrativ zbatohen parimet e ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.⁵

Palët në procedurë

Palët në procedurën e hetimit administrativ i zhvillon zyrtari përgjegjës, si përfaqësues i punëdhënësit dhe palët në procedurë mund të jenë edhe sinjalizuesi dhe personat e tretë që kanë lidhje me rastin. Palët kanë të drejtë: (i) të dëgjohen; (ii) të kenë qasje në dosjen e hetimit; (iii) të paraqesin prova, opinione apo deklarata.

Përfundimi i hetimit

Kur përfundon hetimi administrativ i rastit të sinjalizuar dhe i njëjti paraqet shkelje ligjore, zyrtari përgjegjës (punëdhënësi) merr masat sipas rezultateve të hetimit dhe nëse nevojitet i përcillet organeve kompetente për veprim të mëtejshëm. Organ kompetent në këtë rast mund të jenë organet e ndryshme, varësisht nga natyra e shkeljes administrative apo penale: Komisionit disiplinor; Agjencisë kundër Konkorrupcionit; Auditorit të Përgjithshëm; Prokurorit të Shtetit, Njësisë së Inteligjencës financiare; Administratës Tatimore; Policisë së Kosovës, etj. Nëse shkelja apo veprimi i sinjalizuar vijon të shkaktojë pasoja të dëmshme në interes publik, punëdhënësi merr masa të menjëhershme, për të parandaluar ato.

⁵ Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/21 Qershor 2016. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=12559>

Krijimi i procedurave të brendshme

Subjektet e sektorit privat, në zbatim të Ligjit, duhet të përcaktojnë me një akt të tyre procedurën e sinjalizimit të brendshëm dhe shqyrtimit të tij. Ky akt (rregullore, udhëzim) përshkruan veprimet procedurale brenda organizatës që duhet të bëhen në rastin e sinjalizimit dhe trajtimit të tij. Një model i një akti të tillë është i bashkangjitur në Shtojcën e këtij udhëzuesi.

Sinjalizimi jashtë vendit të punës

Sinjalizimi i jashtëm është raportimi që sinjalizuesi bën në një institucion tjetër jashtë biznesit ku ai punon. Sinjalizuesi mund të bëjë sinjalizim të jashtëm pasi ka kryer sinjalizimin e brendshëm apo drejtpërdrejt të jashtëm, në rastet kur sinjalizimi: (i) ka të bëjë me drejtuesin e punëdhënësit; (ii) ka karakter urgjent që lidhet me rrezik të rëndë apo të menjëhershëm ose me dëme të pakthyeshme; (iii) ka dyshime të arsyeshme se mund të ndërmerren veprime të dëmshme ndaj sinjalizuesit, se provat mund të fshihen ose asgjësohen, nëse ky do të kryente sinjalizim të brendshëm; (iv) kur sinjalizuesi ka dyshime të arsyeshme se procedurat e brendshme nuk janë efektive.

Organet rregullatore

Sinjalizimi i jashtëm për sektorin privat raportohet te institucionet që shërbejnë si rregullatorë përgjegjës⁶ në fushat e ndryshme si në vijim: Administrata Tatimore të Kosovës; Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve; Odat (e Avokatëve; e Mjekëve); Banka Qendrore; Organi shqyrtues i prokurimit publik; Inspektoratet; Divizionet apo Departamentet e ndryshme në kuadër të ministrive. Lidhur me procedurën, afatet dhe trajtimin e rasteve, rregullatorët zbatojnë procedurat e trajtimit të sinjalizimit të brendshëm.

6 Neni 14, i Ligjit nr. 06/L -113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura përcakton: "Agjencia Rregullatorë bënë rregullimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së operatorëve të një tregu të caktuar me qëllim të mbrojtjes së konsumatorëve dhe sigurimit të konkurrencës së lirë. Ligji nr. 06/L -113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura" Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/nr. 7/01 mars 2019, Prishtinë.
<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18684>

Sinjalizimi publik

Sinjalizimi publik mund të bëhet në media; te organizatat joqeveritare; tubime apo rrjete sociale kur sinjalizuesi me arsye beson se: (i) do t'i nënshtrohet ndëshkimit nëse bën raportim të brendshëm apo të jashtëm; (ii) ka gjasa që dëshmitë në lidhje me veprimet e dëmshme përkatëse do të fshihen ose do të shkatërrohen; (iii) në rast të kërcënimit të menjëhershëm për jetën, shëndetin publik, sigurinë apo mjedisin, (iv) nëse sinjalizim i brendshëm dhe i jashtëm nuk është shqyrtuar nga autoritetet përgjegjëse. Në rast se sinjalizuesi zgjedh të bëjë sinjalizim publik, ai duhet të respektojë parimin e prezumimit të pafajësisë të personit të akuzuar, të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe të mos pengojë zhvillimin e procedurave gjyqësore.

Mbrojtja nga veprimet e dëmshme

Sinjalizuesi mbrohet nga çdo veprim i dëmshëm, i cili mund të merret nga punëdhënësi i sektorit privat, për shkak të raportimit apo shpalosjes së informacionit. Të njëjtën mbrojtje e gëzon edhe personi i lidhur me sinjalizuesin. Ligji përcakton se sinjalizuesit mbrohen nga çdo veprim i dëmshëm apo hakmarrës i cili mund t'i shqiptohet atij për shkak të sinjalizimit. Veprimet e dëmshme nga të cilat mbrohet sinjalizuesi janë: 1) shkarkimi nga puna; 2) pezullimi nga puna ose të një ose më shumë detyrave; 3) transferimi brenda ose jashtë institucionit pa pëlqimin e tij; 4) ulja në pozitë; 5) zvogëlimi i pagesës; 6) humbja e statusit dhe privilegjeve; 7) mosngritja në pozitë; 8) heqja e së drejtës për të marrë pjesë në trajnime; 9) vlerësimet negative në marrëdhënien e punës; 10) anulimi i një licence ose lejeje; 11) përfundimi i një kontrate për mallra apo shërbime; 12) veprime të tjera të dëmshme në lidhje me marrëdhënien e punës.

Mbrojtja gjyqësore

Ne rast se ka pësuar nga veprimet e dëmshme, sinjalizuesi ka të drejtë të ushtrojë padi gjyqësore pa qenë i detyruar t'i shterrojë mjetet juridike në procedurën e brendshme administrative në kuadër të punëdhënësit. Padia ushtrohet në afat prej 6 muajsh nga dita kur sinjalizuesi është venë në dijeni dhe jo më vonë se 3 vjet nga dita kur është ndërmarre veprimi i dëmshëm. Padia dorëzohet në Departamentin e Përgjithshëm të Gjykatave Themelore, ku është selia e punëdhënësit apo ku është vendbanimi i sinjalizuesit.⁷

⁷ Ligjit nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Prishtinë: Viti V/Nr. 82/21 Tetor 2010. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2707>

Vendimet e gjykatës

Në të gjitha rastet kur sinjalizuesi apo personi i lidhur me sinjalizuesin pretendon se ka pësuar nga veprime të dëmshme për shkak të sinjalizimit, barra e provës i takon punëdhënësit se veprimi i dëmshëm nuk ka lidhje shkakore me sinjalizimin. Pas gjykimit të rastit, Gjykata kompetente, nese vërteton se sinjalizuesi ka pësuar nga një veprim i dëmshëm vendos sipas rastit, që: (i) ta kthejë në vendin e punës; (ii) kompensimin e dëmit; (iii) urdhëron punëdhënësin publik ose privat të ndërmarrë veprime të caktuara. Lëndët që kanë të bëjnë me sinjalizimin shqyrtohen me prioritet nga Gjykatat.

Dënimet për kundërvajtje

Gjykata kompetente shqipton gjobë prej pesëqind (500) euro deri në njëzetmijë (20.000) euro për subjektin privat si dhe autoritetin kompetent përkatës, në rast se:

1. nuk mbron sinjalizuesin nga ndonjë veprim i dëmshëm ose nuk ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për ndërprerjen e veprimit të dëmshëm;
2. nuk njofton me shkrim të gjithë të punësuarit, lidhur me të drejtat që parashihen me ligj;
3. nuk cakton zyrtarin përgjegjës;
4. nuk ndërmerr veprime pas raportimit të informacionit brenda afatit të përcaktuar me këtë ligj;
5. nuk informon sinjalizuesit për rezultatin e procedurës, brenda afatit të përcaktuar;
6. nuk informon sinjalizuesit, sipas kërkesës së tij, lidhur me ecurinë dhe veprimet e ndërmarra në procedurë, ose nuk i mundëson sinjalizuesit që të ketë qasje në shkresat e lëndës dhe që të marrë pjesë në veprimet e ndërmarra gjatë procedurës së sinjalizimit;
7. në rast se pengon sinjalizimin;
8. në rast se nuk vepron në bazë të parimit të konfidencialitetit.

Gjykata kompetente shqipton gjobë prej pesëqind (500) euro deri në njëzetmijë (20.000) euro për zyrtarin përgjegjës të subjektet privat në rast se është përgjegjës sipas pikave 1, 2, 4, dhe 6 të lartëcekura. Organ kompetent për fillimin e procedurës kundërvajtëse për sektorin privat është Inspektorati i Punës. Nëse organi kompetent brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nuk ndërmerr asnjë veprim apo refuzon të veprojë, atëherë sinjalizuesi vetë mund ta iniciojë procedurën.⁸

⁸ Ligji Nr. 065/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, Neni 27.

Veprimet për zbatim të Ligjit

Punëdhënësit kanë obligim ligjor që të zhvillojnë apo krijojnë udhëzime me shkrim, lidhur me procedurat për sinjalizim. Këto udhëzime mund të jenë në formë të udhëzuesve, doracakëve, manualeve, udhërrëfyesve, të cilët duhet të shpërndahen në mënyrë të përshtatshme tek të punësuarit. Kjo mund të bëhet duke ekspozuar në ambientet e punës dhe në faqet e tyre elektronike.

Raportimi vjetor për rastet e sinjalizimit

Çdo subjekt në kuadër të sektorit privat, ka detyrim ligjor, për ta përgatitur Raportin Vjetor, lidhur me rastet e sinjalizuara për vitin paraprak deri me 31 Dhjetor. Ky Raport përmban rastet e sinjalizimit të brendshëm dhe i dërgohet Agjencisë Kundër Korrupsionit, si institucioni qendror për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit, deri me 31 Janar të vitit vijues. Ky detyrim siguron mes tjerash llogaridhënien e sektorit privat lidhur me zbatimin e Ligjit.

II. REKOMANDIMET

Zbatimi efikas i Ligjit kërkon angazhim dhe qasje të integruar nga qytetarët, institucionet publike, sektori privat, mediat, shoqëria civile. Lidhur me zbatimin e tij në sektorin privat është e rëndësishme:

Rekomandimi 1

Subjektet e sektorit privat të caktojnë zyrtarët përgjegjës për trajtimin e sinjalizimit;

Rekomandimi 2

Të zhvillojnë procedurat e brendshme duke krijuar rregullore apo akt të brendshëm;

Rekomandimi 3

Të njoftojnë të punësuarit e tyre se kush është zyrtari përgjigjeje i caktuar për trajtimin e sinjalizimit;

Rekomandimi 4

Organizimi i trajnimeve për zyrtarët përgjegjës dhe të gjithë të punësuarave në mënyrë që të ngritët niveli i njohurisë për Ligjin dhe mënyrën e raportimit;

Rekomandimi 5

Organizatave mbikëqyrëse: Inspektorati i Punës dhe Agjencitë Rregullatore nevojitet të kenë prioritet monitorimin e zbatimit të këtij ligji;

Rekomandimi 6

Avokimi nga organizatat e shoqërisë civile dhe mediave është pa dyshim thelbësor në ngritjen e vetëdijes qytetare për të sinjalizuar shkeljet e ndryshme që cenojnë interesin publik;

Rekomandimi 7

Rrjetëzimi dhe organizmi i platformave të përbashkëta mes OJQ-ve, duke integruar përvojat e tyre do ta fuqizojnë rolin e tyre për zbatimin e Ligjit.

III. Referencat:

- Ligji Nr. 065/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 22/18 dhjetor 2018, Prishtinë; <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18303>.
- Ligji nr. 06/L -016 për Shoqëritë Tregtare, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/nr. 9/24 maj 2018, Prishtinë, Neni 5. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16426>;
- Ligji nr. 06/L- 043 për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /nr. 11/24 prill 2019, Neni 19, Prishtinë, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=19055>;
- Ligjiti nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Prishtinë: Viti V/ Nr. 82/21 Tetor 2010. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2707>;
- Ligji nr. 06/L -113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura” Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/nr. 7/01 mars 2019, Prishtinë. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18684>;
- Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/21 Qershor 2016. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=12559>.

IV. Shtojcë A

Në bazë të nenit 17.6 të Ligjit Nr. 06/L085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, Kompania "VIZIONI I RI" miraton:

AKTIN PËR PRANIMIN DHE TRAJTIMIN E RASTEVE TË SINJALIZIMEVE

Kreu I Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij akti është përcaktimi i rregullave dhe proceduarve për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimeve të brendshme në kuadër të Kompanisë "VIZIONI I RI" në zbatim të Ligjit Nr. 06/L085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve.

Neni 2

Fushëveprimi

Akti për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimeve vlen për të gjithë të punësuarit në Kompaninë "VIZIONI I RI".

Neni 3

Përkufizime

Për qëllim të këtij akti, shprehjet e mëposhtme do të kenë këto kuptime:

1. *Sinjalizim* - nënkupton raportimin ose shpalosjen e informacionit për veprimet dhe mosveprimet që kryera në vendin e punës të cilat paraqesin kërcënim ose cenim të interesit publik.
2. *Sinjalizues* - nënkupton personin në kontekst të marrëdhënies së tij të punës kompaninë "Vizioni i ri" sinjalizon një veprim apo praktike e cila paraqet shkelje sipas Ligjit Nr. 06/L085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve.
3. *Person në kontekst të marrëdhënies së punës* - nënkupton: (1) të gjithë të punësuarit në Kompaninë "Vizioni i ri"; (2) bashkëpunëtor të jashtëm ose të rastit, vullnetar, në praktikë profesionale ose trajnim (3) kandidatë për tu punësuar apo praktikant dhe (4) personat të cilët mund të jenë kontraktor apo nënkontraktor punësh apo shërbimesh në kompaninë "Vizioni i ri"
4. *Shkelje* - nënkupton çdo veprim ose mosveprim të kundërligjshëm, fakte apo rrethana të kryera në kompaninë "Vizioni i ri", për të cilat sinjalizuesi dyshon me mirëbesim se paraqesin shkaqe të parapara në nenin 5 të ligjit.
5. *Zyrtar Përgjegjës* - nënkupton zyrtarin e caktuar brenda kompanisë i cili është ngarkuar me detyrën e shqyrtimit administrativ të sinjalizimit dhe shqyrtimin e kërkesës për mbrojtjen e sinjalizuesit.
6. *Drejtuuesi i Kompanisë* - nënkupton drejtorin ekzekutiv të kompanisë "Vizioni i ri".

7. *Rregullator*- Organi apo agjencia që bën rregullimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së operatorëve të një tregu të caktuar me qëllim të mbrojtjes së konsumatorëve dhe sigurimit të konkurrencës së lirë.

Kreu II

Parimet e procedurës

Neni 4

Konfidencialiteti

1. Zyrtari Përgjegjës duhet të ruajë në çdo kohë në mënyrë konfidenciale informacionin e lidhur me sinjalizimin, duke mos e përhapur ose transmetuar tek persona të tretë, si dhe të mos e përdorin për qëllime të tjera, përveçse me pëlqimin me shkrim të sinjalizuesit ose për përmbushjen e një detyrimi ligjor.
2. Gjatë procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimit, identiteti i sinjalizuesit u bëhet i ditur personave të tretë vetëm me pëlqimin e tij me shkrim.
3. Zyrtari Përgjegjës në komunikimet me organizatën ku punon sinjalizuesi ose me çdo subjekt apo autoritet tjetër, privat ose shtetëror, respekton detyrimin e konfidencialitetit dhe ua komunikon informacionin e nevojshëm vetëm personave të caktuar për hetimin administrativ ose për marrjen e masave për ndjekjen e fakteve të sinjalizuara, në kuadër të një marrëveshje konfidencialiteti mes palëve.

Neni 5

Mbrojtja e të dhënave personale

1. Të dhënat personale të individëve të përfshirë në hetimin administrativ përpunohen vetëm për zbatim të Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve. Në çdo rast, përpunimi i të dhënave personale kryhet sipas parimeve dhe procedurave të legjislationit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
2. Në rastet kur, në zbatim të kësaj rregulloreje, konstatohet mosrespektim i legjislationit për mbrojtjen e të dhënave personale, çështja i referohet menjëherë Agjencisë për Informim dhe Privatësi.

Neni 6

Parimet e punës së zyrtaarit përgjegjës

1. Zyrtari përgjegjës gjatë shqyrtimit të rasteve të sinjalizimit duhet:
 - 1.1. të veprojë me ndershmëri, paanshmëri dhe efikasitet, duke pasur parasysh interesat legjitime të sinjalizuesit.
 - 1.2. të veprojë në mënyrë të pavarur nga pikëpamja politike dhe çdo influencë tjetër e padrejtë që mund të pengojë realizimin e detyrave, sipas këtij ligji;
 - 1.3. të shmangë çdo konflikt interesi të mundshëm dhe të deklarojë menjëherë tek organizata konfliktin e interesit përpara fillimit të hetimit administrativ të një sinjalizimi;
 - 1.4. të marrë të gjitha masat e përshtatshme për të mbrojtur dokumentacionin dhe provat lidhur me sinjalizimin nga zhdukja, fshehja, ndryshimi, falsifikimi dhe veprime të tjera, të cilat synojnë asgjësimin e tyre;
 - 1.5. të ruajë konfidencialitetin e informacionit dhe të mbrojë të dhënat në përmbajtje të çdo sinjalizimi, në përputhje me nenet 11 dhe 12 të Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve.
2. Veprimet procedurale të kryhen në përputhje me këtë ligj dhe Ligjin përkatës për Procedurën e Përgjithshme Administrative.
3. Gjatë procesit të hetimit administrativ, sinjalizuesi ka të drejtë të mos zbulojë burimet e informacionit.

Kreu III

Procedura e hetimit administrativ

Neni 7

Forma dhe përmbajtja e sinjalizimit

1. Sinjalizimi mund të paraqitet në formë të shkruar ose gojarisht tek Zyrtari Përgjegjës i cili detyrohet ta dokumentojë me shkrim atë me anë të një procesverbal.
2. Sinjalizimi përmban por nuk kufizohet:
 - 2.1. të dhënat e identitetit të sinjalizuesit;
 - 2.2. të dhënat e kontaktit të sinjalizuesit;
 - 2.3. përshkrimin e fakteve dhe rrethanave për të cilat është në dijeni sinjalizuesi për veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit, shoqëruar me provat përkatëse, për aq sa është e mundur;
 - 2.4. referimi, për aq sa është e mundur nga sinjalizuesi, për veprën ose praktikën e dyshuar të korrupsionit;
 - 2.5. në rastin e sinjalizimit të jashtëm, shkaqet ligjore dhe rrethanat e faktit, për aq sa është e mundur nga sinjalizuesi, për përdorimin e mekanizmit të sinjalizimit të jashtëm.
3. Sinjalizuesi mund të zgjedhë të mbetet anonim dhe sinjalizimi pranohet nga Zyrtari Përgjegjës dhe si i tillë, vetëm nëse në të janë shprehur qartë dhe janë arsyetuar shkaqet e anonimatit dhe të dhënat e sinjalizuara sigurojnë një bazë të mjaftueshme për të hetuar në mënyrë administrative shkeljen e dyshuar.
4. Njoftimet për veprimet procedurale, për të cilat Zyrtari Përgjegjës cakton afate, duhet të përmbajnë paralajmërimin e shprehur mbi pasojat e mosrespektimit të afatit.
5. Në rastet kur sinjalizimi nuk është depozituar sipas formës dhe përmbajtjes së kërkuar në pikën 2 të këtij neni, Zyrtari Përgjegjës i kërkon me shkrim sinjalizuesit të korrigjojë këto të meta brenda 7 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për korrigjim.

Neni 8

Regjistrimi i sinjalizimit

1. Sinjalizimet regjistrohen në një regjistër të posaçëm protokollit apo elektronik të krijuar për këtë qëllim.
2. Zyrtari Përgjegjës nuk mund të refuzojë për asnjë shkak regjistrimin e sinjalizimit.

Neni 9

Rastet e konfliktit të interesave

1. Në rastet kur Zyrtari Përgjegjës konstaton apo vihet në dijeni se ai vetë apo persona të lidhur me të janë të përfshirë ose kanë një interes të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë, pasuror ose personal në lidhje me shkeljen e raportuar, detyrohet që të shmangë këtë konflikt interesi duke e deklaruar menjëherë atë tek Drejtuesi i Kompanisë, përpara se të fillojë hetimin administrativ të sinjalizimit.
2. Në rast të ekzistimit të konfliktit të interesit të zyrtarit përgjegjës, sinjalizimi bëhet tek Drejtuesi i Kompanisë.

Neni 10

Sinjalizimi te Drejtuesi i Kompanisë

1. Sinjalizimi mund të bëhet te Drejtuesi i Kompanisë edhe në rastet tjera si në vijim :
 - 1.1. Zyrtari Përgjegjës është i përfshirë në rastin e dyshuar;
 - 1.2. ekziston dyshimi i arsyeshëm se zyrtari është i papërshtatshëm për të paraqitur rastin;
 - 1.3. ekziston dyshim i arsyeshëm se procedurat e brendshme nuk janë efektive.
2. Në rast kur sinjalizimi bëhet te Drejtuesi i Kompanisë, ky i fundit është Zyrtar Përgjegjës.

Neni 11

Mos fillimi i hetimit administrativ

1. Zyrtari Përgjegjës ka të drejtë të mos fillojë hetimin administrativ nëse:
 - 1.1. sinjalizimi përmban fakte dhe rrethana që nuk përbëjnë shkelje sipas nenit 5 të Ligjit dhe sipas përcaktimit të bërë në nenin 5 të kësaj Rregulloreje;
 - 1.2. në rast se nga përmbajtja e sinjalizimit shihet qartë se nuk ka elemente të kundërvajtjes administrative ose të veprës penale.
2. Mos fillimi i hetimit administrativ bëhet me vendim të arsyetuar të Zyrtarit Përgjegjës.

Neni 12

Procedura e hetimit administrativ

1. Zyrtari përgjegjës, gjatë shqyrtimit të sinjalizimit, vepron sipas procedurës së përcaktuar në Ligjin për Mbrojtjen e Sinjalizuesve. Për atë që nuk parashikohet ndryshe në këtë ligj, Zyrtari Përgjegjës zbaton dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.
2. Zyrtari Përgjegjës ka të drejtë të kërkojë informacione dhe dokumente, të urdhërojë inspektime ose analiza, të mbledhë deklarata ose të pyes persona në dijeni për rrethanat e çështjes, apo të konsultohet me ekspertë të fushave të ndryshme.
3. Në hetimin administrativ merr pjesë sinjalizuesi dhe çdo person tjetër i tretë, kur dyshohet se posedon dokumente apo ka dijeni për rrethanat e sinjalizuara, përfshirë edhe të sinjalizuarin, nëse vlerësohet e nevojshme nga njësia përgjegjëse.
3. Secilës palë pjesëmarrëse në hetimin administrativ i garantohet e drejta për një proces të rregullt, në pajtim me përcaktimet procedurës administrative dhe kanë të drejtë:
 - 4.1. të paraqesin prova të cilat kanë vlerë për çështjen;
 - 4.2. të konsultohen me dosjen e hetimit;
 - 4.3. të dëgjohen në lidhje me pretendimet personalisht apo nëpërmjet një përfaqësuesi.

Neni 13

Provat

1. Palët janë të detyruara të paraqesin informacione, prova, dokumente, deklarata apo për t'u paraqitur personalisht përpara Zyrtarit Përgjegjës sa herë që u kërkohet. Çdo shkelje e këtij detyrimi nga ana e zyrtarëve apo organizatave private përbën shkak për fillimin e procedimit ligjor në varësi të shkeljes së konstatuar.
2. Zyrtari Përgjegjës është i detyruar të dokumentojë me shkrim çdo veprim që kryen gjatë hetimit administrativ. Procesverbali duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e njësisë përgjegjëse. Në rast të kontrollit apo këqyrjeve, akti duhet të nënshkruhet edhe nga zyrtarët e organizatës. Nëse këta të fundit nuk janë dakord me përmbajtjen e aktit, kanë të drejtë të paraqesin vërejtje me shkrim, kopja e së cilës i bashkëlidhet aktit.
3. Zyrtari Përgjegjës është i detyruar të regjistrojë çdo provë të paraqitur nga palët dhe të arsyetojë vendimin e mospranimin të tyre nëse vlerëson se prova e paraqitur nuk ka vlerë për çështjen. Kundër këtij vendimi mund të bëhet vërejtje me shkrim, kopja e së cilës i bashkëlidhet aktit. Dokumentet e nevojshme për hetim pranohen nga njësia përgjegjëse pa pagesë.

Neni 14

Mbledhja e provave

1. Gjatë hetimit administrativ njësia përgjegjëse, me qëllim të përcaktimit të gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me rastin , mund:
 - 1.1. të mbledhë deklarata nga palët, dëshmitarët dhe ekspertët;
 - 1.2. të marrë dokumente të tjera të dokumentuara nëpërmjet mjeteve fotografike, të regjistrimit ose mjeteve të tjera teknike;
 - 1.3. të këqyr vende të caktuara;
2. Kur një provë shkresore, nga e cila varet zgjidhja e çështjes ose që ndikon në sqarimin e saj, ka rrezik të manipulohet, zhduket ose të vështirësohet marrja e saj, Zyrtari Përgjegjës kryesisht apo me kërkesën e sinjalizuesit, mund të vendosë marrjen më parë të kësaj prove ose të urdhërojë moskryerjen e asnjë veprimi mbi këto dokumente (sigurimi i provës). Në çdo rast mbahet një procesverbal që nënshkruhet nga personeli që e dorëzon shkresën dhe Zyrtari Përgjegjës i cili e pranon të njëjtën.

Neni 15

Afati për vendimmarrjen

1. Kur një rast sinjalizohet ai duhet të trajtohet sa më shpejt që është e mundur. Pas raportimit, brenda afatit 15 ditor, Zyrtari Përgjegjës njofton sinjalizuesin për statusin e sinjalizimit.
2. Afati për shqyrtimin e rastit të sinjalizimit është 45 ditë dhe në rast të rrethanave specifike përjashtimisht mund të zgjasë edhe 45 ditë tjera, duke mbyllur ciklin kohor prej 90 ditësh nga dita e regjistrimit të rastit.

Neni 16

Përfundimi i hetimit administrativ

1. Zyrtari Përgjegjës përfundon hetimin administrativ nëse:
 - 1.1. gjatë hetimit rezulton se sinjalizimi për veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit është i bazuar, me ç'rast Personi Përgjegjës duhet ta vë në dijeni organin kompetent;
 - 1.2. konstaton se sinjalizuesi nuk ka vepruar në kushtet e mirëbesimit.
2. nëse në përfundim të hetimit administrativ rezulton se veprimi ose praktika e dyshuar e sinjalizuar përbën ose mund të përbëjë një shkelje sipas ligjit, njësia përgjegjëse detyrohet të vërë menjëherë në dijeni organin kompetent.
3. Zyrtari përgjegjës merr masa të menjëhershme, të çastit dhe për aq sa është e mundur, për të parandaluar ose penguar vazhdimin e pasojave të dëmshme nga veprimi ose praktika e shkeljes së sinjalizuar.
4. Në dosjen e sinjalizimit shënohen vendimi për përfundimin e hetimit administrativ, i arsyetuar për të gjitha shkaqet që kanë çuar në vendimmarrjen përkatëse, si dhe masat e marra në lidhje me sinjalizimin.

Neni 17

Njoftimi i sinjalizuesit

1. Njësia përgjegjëse njofton sinjalizuesin për çdo masë të marrë në përgjigje të sinjalizimit jo më vonë se 30 ditë nga momenti i kryerjes së veprimit.

2. Pavarësisht nga afati i njoftimit të parashikuar në këtë pikë, Zyrtari Përgjegjës është i detyruar t'i përgjigjet brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës për informacion, të paraqitur me shkrim nga sinjalizuesi, në çdo kohë, në lidhje me çështjen e sinjalizuar prej tij.

Neni 18

E drejta e sinjalizuesit për të ju drejtuar drejtpërdrejtë një Rregullatori apo Agjencisë Kundër Korrupsionit

1. Sinjalizuesi ka të drejtë të sinjalizojë shkeljen e dyshuar të korrupsionit pranë Rregullatorit apo Agjencisë Kundër Korrupsionit, në rastet kur:
 - 1.1. Zyrtari përgjegjës nuk fillon hetimin administrativ sipas dispozitave të ligjit apo të kësaj Rregullorja.
 - 1.2. ka dyshime të arsyeshme se Zyrtari Përgjegjës apo Drejtuesi i Kompanisë ose persona të lidhur me të janë përfshirë ose kanë interes të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë, pasuror ose personal, në shkeljen e dyshuar.
 - 1.3. ka arsye të tjera të bazuara për të dyshuar në integritetin dhe paanshmërinë e Zyrtarit Përgjegjës e në shqyrtimin e sinjalizimit, sipas parimeve të ligjit dhe Rregullores;
 - 1.4. prova e sinjalizuesit, në lidhje me veprimin ose praktikën e dyshuar mund të fshihet ose të shkatërrohet nga organizata.
 - 1.5. Në këtë rast, nëse Zyrtari Përgjegjës e ka filluar hetimin, detyrohet ta ndërpresë atë duke bërë shënimin përkatës në dosje.

Neni 19

Raporti i Rregullores dhe Ligjit

Në rast të konfliktit mes dispozitave të këtij akti dhe Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve vlejné dhe zbatohen dispozitat e ligjit.

Neni 20

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hynë në fuqi 7 (shtatë) ditë pas miratimit të saj nga Menaxhmenti i Kompanisë "Vizioni i ri".

Data : _____

Personi Zyrtar : _____

Vendi : _____

Nënshkrimi : _____

V. Shtojca B

Analizë e gjendjes aktuale në lidhje me zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve në sektorin privat

Sinjalizimi ka dëshmuar të jetë ndër mënyrat më efektive të luftimit të krimit dhe korrupsionit. Duke zbuluar informacione rreth keqpërdorimeve në institucione, sinjalizuesit ndihmojnë në uljen e keqpërdorimeve që e dëmtojnë interesin publik, sigurinë, integritetin financiar dhe sundimin e ligjit. Megjithatë, deri vonë, mungesa e hapësirës për raportim e mbi të gjitha mungesa e politikave mbrojtëse ndaj sinjalizuesve si brenda vendit ku punojnë, por edhe jashtë tij, i ekspozon sinjalizuesit ndaj hakmarrjes, duke i bërë ata ta vejnë në pikëpyetje faktin nëse duhet ta raportojnë krimin apo jo. Ndonëse në esencë, sinjalizimi ka të bëjë me angazhimin publik për të mirën e përgjithshme, ekziston perceptimi negativ në shoqëri ndaj sinjalizuesve, të cilët shpesh marrin epitetin e spinëve. Prandaj ka qenë shumë e rëndësishme që korniza ligjore që rregullon sinjalizimin të definojë qartë termat, në mënyrë që të inkurajohet sinjalizimi dhe të pranohet në shoqëri si akt i cili ndikon në uljen e aktiviteteve korruptive.

Duhet të theksohet se niveli i korrupsionit në Kosovë perceptohet si problemi i dytë më i madh në shoqëri⁹ dhe renditet vetëm pas papunësisë. Ndërkaq bizneset konsiderohet se janë të prekur në masë të madhe nga kjo dukuri. Në raportin "Korrupsioni nga ana e ofertës - perspektiva e bizneseve" theksohet se perceptimi i përgjithshëm i 500 bizneseve të anketuara, tregon se ka një konsensus se korrupsioni në shoqërinë kosovare është mjaft i përhapur, me fokus kryesor në institucionet qendrore, prokurim publik, dhe në marrjen e lejeve të ndërtimit dhe licencave.¹⁰ Për më tepër, thuhet dy të tretat e bizneseve konsiderojnë se nuk ka shërbim që është i ndërlidhur me institucione publike, që mund të merret pa dhënë ryshfet. Diku 73% e bizneseve konsiderojnë korrupsionin si një problem serioz për kryerjen e veprimtarisë biznesore. Vetëm 27% e tyre e mohojnë se është problem. Megjithatë, vetëm gjysma e bizneseve të anketuara konsiderojnë korrupsionin të jetë i përhapur në sektorin ku ata operojnë. Tutje, bizneset mendojnë se rreth 25% e kompanive në sektorin e tyre janë të përfshira në afera korruptive.¹¹

Raportimi i korrupsionit mbetet një hap shumë i rëndësishëm por që është sfidë në vete. Sipas raportit "Studim mbi Perceptimin e Korrupsionit 2019"¹², në total, 22% e të anketuarve që janë përballur me korrupsion e kanë raportuar atë tek autoritetet përkatëse. Me gjithë përmirësimin e vogël në krahasim me studimin e vitit 2018, nivelet e raportimit janë akoma shumë të ulëta, dhe si të tilla nuk janë të kënaqshme. Kjo e dhënë sugjeron nevojën për analiza të mëtutjeshme dhe adresimin e faktorëve që ndikojnë në këtë hezitim të bizneseve për raportim të korrupsionit, të cilat radhiten si në vijim: frika e hakmarrjes nga institucioni në të ardhmen (65%), mungesa e besimit në gjyqësor (47%) dhe rezultatet e pakënaqshme në luftën kundër korrupsionit (32%). Më tutje, ryshfeti, keqpërdorimi i pasurisë publike, nepotizmi dhe klientelizmi radhiten si tri format më të pranishme të korrupsionit në Kosovë. Arsyet kryesore që i shtojnë bizneset të përfshihen në korrupsion përfshijnë: shmangien e ndëshkimit, sigurimin për trajtim favorizues në ndonjë proces të hapur/konkurrues dhe përfitimin për qasje në një shërbim të veçantë.

9 UNDP. 2018. Raporti Vjetor. Prishtinë.

10 INSTITUTI RIINVEST. 2019. Korrupsioni nga ana e ofertës - perspektiva e bizneseve. Prishtinë.

11 Ibid.

12 Oda Ekonomike Amerikane e Kosovës. 2019. Studim mbi Perceptimin e Korrupsionit 2019. Prishtinë.

Duke pasur parasysh të gjeturat e mësipërme, duhet të shënohet progres në adresimin e faktorëve që fuqizojnë hezitimin e bizneseve për raportimin e korrupsionit por edhe keqpërdorimeve të tjera që mund të hasen gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre. Duhet pasur parasysh që korrupsioni, nepotizmi, keqpërdorimi i pasurisë publike kanë pasoja negative mbi konkurrencën e drejtë dhe të barabartë, zhvillimin ekonomik, investimet dhe në imazhin e biznesit.

Bazuar në atë që u tha më lartë, sinjalizuesit luajnë rol thelbësor në mbrojtjen e interesit publik duke raportuar apo shpalosur shkeljet e ndryshme të cilat të kryhen si në sektorin publik edhe privat. Të sinjalizuarit dhe mbrojtja e personave që sinjalizojnë është një prej të drejtave themelore që burojnë nga e drejta e lirisë së shprehjes e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me Konventën Evropianë për të Drejtat dhe Liritë themelore të Njeriut. Ligji Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve (tutje Ligji) është një mekanizëm efikas për mbrojtjen e sinjalizuesve dhe ofron një perspektivë të re në luftimin e dukurive negative dhe krijon një qasje afirmative për interesin publik. Komponenti më i rëndësishëm në këtë ligj është garantimi për mbrojtje për këdo që do të sinjalizojë një praktikë apo veprim që përbën shkelje të ligjit.

Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, i cili është tashmë në fuqi, përbëhet nga 32 nene me të cilat në mënyrë më të detajuar rregullohet e tërë procedura e sinjalizimit. Pra ky ligj përcakton rregullat dhe procedurat e sinjalizimit, të drejtat dhe mbrojtja e sinjalizuesve, si dhe detyrimet e institucioneve publike dhe subjekteve private në lidhje me sinjalizimin.¹³ Përveç raportimit të shkeljeve nga institucionet e sektorit publik, ky ligj rëndësi i kushton edhe sektorit privat, dispozitat e të cilit kanë filluar të zbatohen një vit pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji (në janar 2020).

Në kuptim të këtij ligji, sinjalizues quhet çdo person i cili raporton ose shpalos informacione për një kërcënim ose cënim të interesit publik në kontekstin e marrëdhënies së vet të punës në sektorin publik ose privat dhe çdo sinjalizues ka të drejtën e mbrojtjes së identitetit të tij gjatë procesit të sinjalizimit; ruajtjen e fshehtësisë së burimit të informacionit të sinjalizuar, si dhe mbrojtjes kundër veprimeve të dëmshme. Këto të drejta i janë garantuar sinjalizuesit gjatë kohëzgjatjes së hetimit, pas procedurës së hetimit, si dhe pas përfundimit të marrëdhënies së punës. Gjithashtu, sipas këtij ligji, sinjalizuesi apo personi që shpalos informata nuk mund të jetë subjekt i përgjegjësisë penale ose civile apo procedurave disiplinore për shkak të sinjalizimit të tij.

Sipas nenit 13 të këtij ligji, ekziston sinjalizimi i brendshëm, i jashtëm dhe publik. Në rastin e sinjalizimit të brendshëm, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat, sipas këtij neni, informacioni raportohet tek punëdhënësi (personi përgjegjës për pranimin e sinjalizimeve). Punëdhënës sipas dispozitave të këtij ligji nënkuptohet çdo institucion publik dhe subjekt privat.

Ndërsa, sipas ligjit, procedura për sinjalizim të jashtëm për sektorin publik inicohet me raportimin e informacionit tek Agjencia kundër Korrupsionit, si autoritet kompetent, ndërsa për sektorin privat procedura inicohet tek rregullatorët sipas fushave të përgjegjësisë.

Në nenin 17 të këtij ligji është përcaktuar se punëdhënësi publik i cili ka më shumë se pesëmbëdhjetë (15) të punësuar, dhe punëdhënësi privat, i cili ka më shumë se pesëdhjetë (50) të punësuar janë të obliguar të caktojnë zyrtarin përgjegjës, i cili është përgjegjës për ta pranuar dhe trajtuar sinjalizimin.

Mirëpo ky ligj i ka dhënë mundësi sinjalizuesit që të raportojë edhe direkt tek drejtuesi i punëdhënësit (drejtuesi i institucionit publik apo privat), në rast se punëdhënësi nuk ka caktuar zyrtar përgjegjës, nëse punëdhënësi nuk ka përcaktuar dhe publikuar procedura të brendshme për pranimin dhe

¹³ Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, 2018.

trajtimin e sinjalizimeve, nëse sinjalizuesi ka dyshime të arsyeshme se zyrtari përgjegjës është ose mund të përfshihet në praktikën e dyshuar të sinjalizimit, nëse sinjalizuesi ka dyshime të arsyeshme se zyrtari përgjegjës për shkak të çfarëdo marrëdhënie ose shoqërie me një person mund të jetë i përfshirë në çështjen e pretenduar në sinjalizim, nëse nuk është personi i përshtatshëm për t'u informuar me sinjalizimin, si dhe nëse sinjalizuesi ka dyshime të arsyeshme se procedurat e brendshme të sinjalizimit nuk janë efektive.

Sipas dispozitave përfundimtare të këtij ligji, Agjencia Kundër Korrupsionit për sektorin publik dhe Inspektorati i Punës për sektorin privat obligohen të fillojnë procedurat sipas ligjit për kundërvajtje ndaj punëdhënësve dhe zyrtarëve përgjegjës të cilët nuk i kanë përmbushur obligimet sipas këtij ligji.

Sipas paragrafit 6 të nenit 17 të këtij Ligji, subjektet private obligohen që të krijojnë akte të brendshme për të përcaktuar procedurën e pranimin dhe trajtimin të rasteve të sinjalizimit. Kjo nënkupton se institucionet e sektorit privat duhet të sjellin një akt të brendshëm i cili në kuadër të kompanisë private do të garantonte të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, përkatësisht do të përcaktonte personin përgjegjës për pranimin e sinjalizimit, procedurën e sinjalizimit si dhe trajtimin e mëtutjeshëm të rastit, në kuadër të fushëveprimit të këtij ligji.

Zgjidhje të tillë ligjore ka pranuar edhe Republika e Maqedonisë së Veriut, ku në Ligjin për Mbrojtjen e Sinjalizuesve të R.M.V., në paragrafin 6 të nenit 4 të këtij ligji, thuhet se sinjalizimi i brendshëm në sektorin privat rregullohet me akt të brendshëm.¹⁴ Ky ligj gjithashtu e obligon ministrin e Drejtësisë për miratimin e udhëzimeve për miratimin e akteve të brendshme (në paragrafin 8 të nenit 4). Ndërkaq ndryshe nga ligji jonë, mbikëqyrjen mbi zbatimin e dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, sipas këtij ligji, e kryen Ministria e Drejtësisë.

Ndërsa Ligji për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve i Republikës së Shqipërisë, në paragrafin 3 të nenit 10 të tij e obligon Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) që të përcaktoj me udhëzim strukturën, kriteret e përzgjedhjes dhe trajnimin e punonjësve për shqyrtim të hetimit administrativ të sinjalizimit të subjekteve private¹⁵. Sipas këtij ligji, çdo organizatë publike ose private, sipas udhëzimeve të ILDKPKI- së duhet të miratoj rregullore të brendshme të posaçme për procedurën e shqyrtimit të hetimit administrative të sinjalizimit dhe mekanizmat e mbrojtjes së konfidencialitetit.

Ndërkaq sa i përket rregullimit të sinjalizimit në kuadër të Bashkimit Evropian duhet theksuar se Parlamenti Evropian në vitin 2019 ka sjellë Direktivën 2019/1937 për mbrojtjen e personave të cilët raportojnë shkelje.¹⁶ Në nenin 8 të kësaj direktive obligohen shtetet anëtare që të sigurojnë se personat juridik privat që kanë pesëdhjetë (50) e më shumë të punësuar të krijojnë kanale dhe procedura për raportim të brendshëm të informacioneve mbi shkeljet që ndodhin në këto institucione.

Sipas kësaj direktive, procedurat për raportim dhe përcjellje të shkeljeve, si për sektorin publik ashtu edhe për atë privat, duhet të garantojnë konfidencialitetin të personit raportues, të caktohet një person ose departament kompetent për dërgimin e raporteve, të siguroj informacion të qartë dhe lehtësisht të arritshëm në lidhje me procedurat e raportimit, si dhe të siguroj përgjigje për personin raportues brenda një afati të arsyeshëm, që nuk mund të kaloj 3 muaj pas raportimit.

¹⁴ Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr.196/15, 35/18). 2015. Ligjit për Mbrojtjen e Denoncuesve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

¹⁵ Republika e Shqipërisë - Kuvendi. 2016. Ligji Nr. 60/2016 për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve. Tiranë.

¹⁶ European Union. 2019. DIRECTIVE (EU) 2019/1937 OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 23 October 2019 on the protection of persons who report breaches of Union law.

Pas sjelljes së kësaj direktive, shtetet anëtare të Bashkimit Evropian (si dhe shtetet që janë në proces të anëtarësimit) kanë qenë të obliguara që të sjellin akte ligjore, përkatësisht ti përshtatin me frymën dhe qëllimin e direktivës.

FOL, që nga viti 2019, është angazhuar në monitorimin e zbatimit të LMS-së në sektorin publik, kurse nga viti 2020 ka filluar edhe monitorimin e këtij ligji edhe në sektorin privat. Gjatë takimeve që ka pasur me Inspektoratin Punës dhe me disa nga Odat e Ekonomike, ka vërejtur që ky Ligj ende është i panjohur nga sektori privat edhe pse ka hyrë në fuqi në janar të këtij viti. Duke marrë parasysh sfidat që ka krijuar pandemia COVID-19 e që bizneset janë prekur në masë të madhe, ka qenë tejet e vështirë të bëhet një monitorim më i detajuar në lidhje me gatishmërinë e bizneseve për implementimin e këtij Ligji

Duhet të potencohet se formalizimin i sinjalizimit si një praktikë e mirëfilltë, e pranuar nga shoqëria, që ekspozon dhe parandalon krimin dhe korrupsionin, tashmë e mbulon Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve. Si i tillë, është e rëndësishme dhe kuptueshme që ky Ligj duhet të respektohet dhe promovohet vazhdimisht, e në veçanti në sektorin privat. Prandaj është më se e nevojshme që përpjekjet institucionale të suplementohen me një fushatë avokuese e cila duhet të zhvillohet në aspektin promovues dhe informues. Në hap me informimin dhe promovimin e këtij Ligji, FOL ka publikuar Doracakun me 10 skenarë të reagimit për rastet e sinjalizimit në sektorin privat, kurse kjo analizë e gjendjes aktuale në lidhje me zbatimin e Ligjit në sektorin privat është shtojcë e Udhëzuesit për sinjalizimin në sektorin privat.

